

VENDIM
Nr.270, datë 7.5.2004

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË KOMITETIT SHTETËROR
TË MINORITETEVE TË DISA MJEDISEVE, PËR USHTRIMIN E
VEPRIMTARISË SË KËTIJ KOMITETI**

(Ndryshuar me VKM nr. 535, datë 19.7.2005)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dy *apartamente*, përkatësisht nr.6, 1+1, me sipërfaqe 50.6 m², shkalla I, dhe nr.21, 2+1, me sipërfaqe 64,7 m², shkalla II, pallati nr.57, bulevardi “Zogu i I”, në përdorim të Drejtorisë së Shërbimeve të Trupit Diplomatik, në varësi të Ministrisë së Punëve të Jashtme, t’i kalojnë në përgjegjësi administrimi Komitetit Shtetëror të Minoriteteve, për ushtrimin e veprimtarisë.

2. Ngarkohen Ministri i Punëve të Jashtme, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, kryetari i Komitetit Shtetëror të Minoriteteve dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano